

30 DITË në AMA

DËRGO ANKESË PËR RADIO DHE TELEVISIONE



Fq. 2

Konferenca ndërkombëtare për “Përfaqësimin e grave në media”, Krasniqi: Përfaqësimi gjinor në Shqipëri, i balancuar

AMA Marrëveshje Bashkëpunimi me ISHMT. Prioritet e drejta e transmetimit

Kryetarja e AMA-s, znj. Armela Krasniqi ka nënshkruar një Memorandum Bashkëpunimi me kreun e Inspektoriatit...



Fq. 2



Fq. 3

Aleanca Kundër Gjuhës së Urrejtjes: Edukimi Mediatik, investim për mbrojtjen e publikut


“Edukimi Mediatik si mjet për të luftuar gjuhën e urrejtjes”, ishte tema kryesore e takimit të Aleancës Kundër Gjuhës së Urrejtjes, organizuar....

Monitorimi i zgjedhjeve, kryetarja e AMA-s në takimin e organizuar nga OSBE/ODIHR

Zgjedhjet e vitit të kaluar në Rumani, problematikat e ndeshura dhe mësimet që dalin prej tyre, ishin thelbi i takimit të OSBE/ODIHR, organizuar...



Fq. 2



Fq. 3

Mbrojtja e të drejtave të minoriteteve në transmetimet audiovizive, delegacioni estonez në AMA

Respektimi i të drejtave të minoriteteve në transmetimet audiovizive në Shqipëri, ishin thelbi i takimit të delegacionit estonez, i cili u zhvillua në Autoritetin e Mediave Audiovizive....

Konferenca ndërkombëtare për “Përfaqësimin e grave në media”, Krasniqi: Përfaqësimi gjinor në Shqipëri, i balancuar

Kryetarja e AMA-s Znj. Armela Krasniqi mori pjesë në punimet e konferencës ndërkombëtare të organizuar nga rregullatori turk, RTUK, mbajtur në Ankara, me temë “Përfaqësimi i grave në media”. “Në peizazhin mediatik, mjaft dinamik shqiptar, përfaqësimi gjinor në media është i balancuar”- u shpreh Znj. Krasniqi. [Lexo më shumë](#)



AMA Marrëveshje Bashkëpunimi me ISHMT. Prioritet e drejta e transmetimit

Kryetarja e AMA-s, znj. Armela Krasniqi ka nënshkruar një Memorandum Bashkëpunimi me kreun e Inspektoriatit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut, Edison Konomi. Kjo marrëveshje synon të sigurojë, parandalojë dhe ndalojë shkeljen e të drejtave të transmetimit dhe të ndihmojë në ndërgjegjësimin për respektimin e të drejtës së autorit dhe të drejtat e lidhura me të, në transmetimet audio dhe audiovizive. [Lexo më shumë](#)



Aleanca Kundër Gjjuhës së Urrejtjes: Edukimi Mediatik, investim për mbrojtjen e publikut

“Edukimi Mediatik si mjet për të luftuar gjuhën e urrejtjes”, ishte tema kryesore e takimit të Aleancës Kundër Gjjuhës së Urrejtjes, organizuar nga Këshilli i Europës, KiE. Në tryezë merrnin pjesë Shefja e zyrës së KiE-s në Tiranë, Znj. Giulia Re, Shefja e Sektorit të Drejtësisë pranë Delegacionit të BE-së, Znj. Cinzia Tarletti dhe drejtues të institucioneve që janë pjesë e Aleancës.

[Lexo më shumë](#)

AMA bën transparencë mbi pronarët e medias audio dhe audiovizive



Zgjedhjet e vitit të kaluar në Rumani, problematikat e ndeshura dhe mësimet që dalin prej tyre, ishin thelbi i takimit të OSBE/ODIHR, organizuar në Bukuresht. Ky seminar është pjesë e projektit të OSBE/ODIHR për mbështetjen e reformës zgjedhore në Ballkanin Perëndimor. Në këtë takim mori pjesë edhe kryetarja e Autoritetit të Mediave Audiovizive.

[Lexo më shumë](#)



Mbrojtja e të drejtave të minoriteteve në transmetimet audiovizive, delegacioni estonez në AMA

Respektimi i të drejtave të minoriteteve në transmetimet audiovizive në Shqipëri, ishin thelbi i takimit të delegacionit estonez, i cili u zhvillua në Autoritetin e Mediave Audiovizive. Znj. Krasniqi i shpjegoi atyre mënyrën e funksionimit të institucionit, përcaktimet ligjore që garantojnë të drejtat e pakicave kombëtare, duke siguruar qasje në përmbajtjet audio dhe audiovizive pa dallim race apo përkatësie etnike, si dhe mbrojtjen e tyre nga diskriminimi.

[Lexo më shumë](#)

Monitorimi i përmbajtjeve: Politika mbizotëron në lajmet e muajit Shkurt

Temat politike kanë zënë vendin kryesor në edicionet informative me 23.75%, ndërsa kanë lënë pas lajmet nga bota dhe tematikat sociale, të cilat kanë qenë më të trajtuarat qysh prej muajit gusht 2024. Këto janë gjetjet e ekipeve të monitorimit të AMA-s për muajin shkurt, monitorime të cilat kryhen çdo muaj.


[Lexo më shumë](#)



Sfidat e përfaqësimit të grave në politikë dhe zgjedhje, Krasniqi: Bashkëpunim ndërinstytucional për rezultate të vërteta

Sfidat me të cilat përballen gratë në politikë, gjuha e urrejtjes, dhuna dhe pengesat që ndikojnë në përfaqësimin e tyre, ishin tema e aktivitetit të zhvilluar nga Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim (GADC). Sipas Znj. Krasniqi nevojitet bashkëpunim ndërinstytucional dhe koordinim shumëplanësh për të arritur në rezultate të vërteta.

[Lexo më shumë](#)



Copyright (C) 2024 Audiovisual Media Authority. All rights reserved.

Our mailing address is:

info@ama.gov.al

+355 422 33006